



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK nr. 192 /2012

Datë, 08/tetor/2012

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 4 par.1.16 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 08/tetor/2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS PËR SJELLJEN PROFESIONALE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

- I. Miratohet Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e KGJK-së
- II. Obligohet Sekretariati i KGJK-së të bëjë publikimin e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e KGJK-së në ueb faqen e KGJK-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Enver Peci,

Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Albert Avdiu, Drejtor, Sekretariati i KGJK-së
- Anëtarëve të KGJK-së
- Departamentit Ligjor të Sekretariatit të KGJK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/SUDSKI SAVET KOSOVA/KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Duke iu referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,

Duke u bazuar në Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Pushtetit Gjyqësor, të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor 1985; gjithashtu edhe në Rekomandimin CM/Rec(2010)12 të Komitetit të Ministratave për gjyqtarët e shteteve anëtare: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësia,¹

Duke njohur rolin thelbësor që luan Këshilli Gjyqësor i Kosovës në sigurimin se të gjithë kanë qasje në drejtësi duke siguruar se gjyqësori është i pavarur, profesional dhe i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore,

Duke pasur parasysh standardet dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë secilit parimin e barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj,

Duke qenë në pajtim me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë me të cilat anëtarëve të Këshillit Gjyqësor u garantohet liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit si çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, anëtari i Këshillit Gjyqësor duhet gjithmonë të sillet brenda dhe jashtë Këshillit, në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin e funksionit të tij, si dhe paanësinë dhe pavarësinë gjyqësorit; dhe të sigurojë se roli i Këshillit në administrimin e drejtësisë është ruajtur,

Duke pasur parasysh se parimi i ndarjes së pushtetit duhet të respektohet në lidhje me detyrat e Këshillit Gjyqësor, dhe

Duke pasur parasysh se sjellja e duhur etike dhe perceptimit i sjelljes së duhur etike janë esenciale për performancën e të gjitha aktiviteteve të Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës miraton:

¹ Aprovuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010 në mbledhjen e 1098-të të Zëvendës Ministrave.

KODIN E ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Ky Kod përkufizon standardet të etikës dhe sjelljes profesionale që duhet të zbatohen nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Shkelja e këtij Kodi mund të përbëjë bazën për sanksionim, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe vlen për të gjithë anëtarët e Këshillit.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Anëtari i Këshillit gjatë të gjithë kohës, do të veprojë në atë mënyrë që të ruajë dhe promovojë besimin e publikut në dinjitetin, integritetin, efektivitetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit dhe Këshillit.
2. Anëtari i Këshillit:
 - a. Respekton standarde të larta të sjelljes profesionale dhe personale;
 - b. Respekton dhe i përmbahet ligjit dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme;
 - c. Kryen detyrat e Këshillit në mënyrë të pavaruar, të paanshme dhe me profesionalizëm të lartë;
 - d. Shmangë çdo sjellje apo situatë që mund të vëjë në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë e tij/saj apo atë të Këshillit, dhe menjëherë i raporton Kryesuesit të Këshillit për çfarëdo përpjekje për të shkelur këto parime;
 - e. Kryen detyrat sipas standardeve dhe parimeve ndërkombëtarisht të njohura për të drejtat e njeriut
 - f. Respekton sundimin e ligjit, promovon integritetin, pavarësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e gjyqësorit, si dhe interesat e administrimit të drejtësisë
 - g. Nxitë këto parime gjatë ushtrimit të të gjitha kompetencave, detyrave dhe përgjegjësiave të tij/saj.
3. Dispozitat e sipërme vlejnë jo vetëm për aktivitetet profesionale të anëtarit të Këshillit, por edhe për jetën private të tij/saj dhe kryerjes së rregullt të detyrave profesionale të tij/saj, sepse veprimet e anëtarit të Këshillit dëmtojnë imazhin e Këshillit në syrin publik, e kështu ndikon tërë institucionin.
4. Anëtari i Këshillit nuk përfshihet në asnjë veprimtari, përfshirë veprimtari politike, që është e papajtueshme me funksionet e tij/saj.
5. Anëtari i Këshillit duhet të japë dorëheqje nga roli i tij si Anëtar i Këshillit në rast të kryerjes së veprës penale, me përjashtim të kryerjes së veprave kundërvajtëse, siç parashihet me ligj.
6. Anëtari i Këshillit ka për detyrë që të veprojë në mirëbesim gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave, duke respektuar faktet dhe procedurat në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe aktet nënligjore.

7. Sjellja e duhur etike dhe perceptimi i sjelljes së duhur etike, janë esenciale në kryerjen e të gjitha aktiviteteve të një anëtari të Këshillit Gjyqësor.
8. Anëtarëve të një Këshilli Gjyqësor u garantohet liria e shprehjes, besimit, mbledhjes dhe organizimit si çdo qytetari tjetër, megjithatë, gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, anëtari i një Këshilli Gjyqësor duhet gjithmonë të sillet në atë mënyrë që të mbrojë dinjitetin, paanësinë dhe pavarësinë e Gjyqësorit dhe Këshillit.
9. Anëtari do të jete aktiv në punën e Këshillit dhe do t'i përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij ne menyre te përgjegjshme dhe në interesin më të mirë të Gjyqësorit dhe Këshillit.
10. Anëtari duhet të respektojë parimin e vendimmarrjes kolektive dhe përgjegjësisë se përbashkët.. Anëtari i Këshillit nuk duhet të kritikojë publikisht punën dhe vendimet e Këshillit.
11. Format specifike të sjelljes së pahijshme të përshkruara në këtë Kod nuk janë gjithëpërfshirëse. Çdo sjellje e pahijshme apo veprim i tillë i anëtarit të Këshillit, edhe nëse nuk parashihet shprehimisht me dispozitat e këtij kodi , apo në kodet, ligjet ose në aktet e tjera ligjore dhe nenligjore mund të konsiderohet shkelje dhe për rrjedhojë mund të sanksionohet.

Neni 3

Rregullat dhe aktivitetet specifike të etikës

1. Anëtari i Këshillit u përmbahet standardeve më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore dhe për të arritur këtë qëllim konform rolit të tij/saj si anëtar i Këshillit, do të ndjekë trajnime profesionale.
2. Në veçanti, anëtari i Këshillit respekton dhe zbaton:
 - a. Parimet etike të përshkruar në këtë Kod.
 - b. Të drejtën e palëve të angazhuara në procedurë para Këshillit.
 - c. Të drejtat dhe liritë e pranuar ndërkombëtarisht.
 - d. Parimet dhe praktikat e organizimit të punës, menaxhimit dhe burimeve njerëzore në kontekst gjyqësor.
3. Anëtari i Këshillit do të ketë dijeni për:
 - a. Mekanizmat dhe materialet në dispozicion që kontribuojnë në vijimësinë e veprimtarive të tij/saj.
 - b. Kornizën ligjore dhe kushtet e punës në të cilin gjyqtarët ushtrojnë funksionet e tyre.
4. Anëtari i Këshillit mbanë përgjegjësinë për të shmangur konfliktin e interesit në bazë të marrëdhënieve familjare dhe shoqërore në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për parandalimin e konfliktit të interesit.

5. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit mëson për ndonjë konflikt interesi apo për çfarëdo rrethana të tjera që opinioni i gjerë mund të perceptojë apo të ketë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do t'i ndërpresë të gjitha veprimtaritë mbi rastin dhe menjëherë njofton Kryesuesin e Këshillit me shkrim në lidhje me atë situatë. Në situatën e njejtë kur Kryesuesi është subjekt i konfliktit të interesit ai/ajo do të njoftojë menjëherë Këshillin.
6. Në çdo rast, nëse anëtari i Këshillit, e fshehtë, respektivisht nuk e raporton ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit apo çfarëdo rrethane tjetër që mund të ngrisë dyshime në lidhje me paanësinë e tij/saj, por ndonjëri nga anëtarët e Këshillit ka njohuri për këtë rrethanë, do të ishte e detyrueshme për këtë anëtar që këtë rrethanë t'ia raportojë Kryesuesit të Këshillit.
7. Anëtari i Këshillit respekton parimin e ndarjes së pushteteve-pavarësinë gjyqësore, ekzekutive, prokuroriale dhe legjislative, dhe në asnjë rrethanë nuk bën përpjekje të pengojë dhe nuk pengon apo ndikon pavarësinë e atyre institucioneve. Ai/ajo në asnjë rrethanë nuk jep mendimin e tij/saj për ndonjë vendim gjyqësor, nuk bën përpjekje dhe nuk pengon ndonjë përmbarim të vendimit, apo kritikon Këshillin Prokurorial apo Gjyqësor, përveç në raste të diskutimit në Këshill.
8. Anëtari i Këshillit promovon marrëdhënie profesionale dhe funksionale në mes të gjyqtarëve dhe personelit administrativ në institucionin gjyqësor, polici dhe agjensitë tjera të zbatimit të ligjit.
9. Në raportin e tij/saj me individë apo anëtarë të Këshillit, do të:
 - a. zbatojë funksionet e tij/saj me me dinjitet dhe në mënyrë të drejtë, të paanshme, objektive dhe njerëzore.
 - b. respektojë dhe kërkojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
 - c. shmanget nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ndaj çdonjërit person apo persona mbi çfarëdo baze, përfshirë gjininë, moshën, gjendjen martesore, gjuhën, paftësinë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësinë apo bindjen politike, origjinën etnike, kombësinë, fenë apo besimin, racën, origjinën shoqërore, të lindjes apo çdo status tjetër.
 - d. sigurojë barazinë në procedurat e Këshillit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e ndryshme që ndikojnë procedurën dhe vendimin e drejtë.
10. Anëtari i Këshillit:
 - a. Nuk ndikohet nga interesat e palëve të treta, opinionit publik ose frika nga kritikant.
 - b. Synon ruajtjen e parimit të barazisë së palëve duke u shpalosur informata të gjitha palëve në procedurë të Këshillit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, në veçanti nëse dështimi për ruajtjen e informacionit mund të rezultojë me efekt të pafavorshëm në procedurat e drejta.
 - c. Mbanë informatat konfidenciale të pranuar nga palët e treta, përveç nëse kërkohet shpalosja e tyre në interes të drejtësisë apo me ligj.
 - d. Merr parasysh interesat e individëve që marrin pjesë në procedurë para Këshillit.

- e. Shmangë ndikimin e padrejtë në punën e Këshillit.
 - f. Ai/ajo dhe as familjarët e ngushtë të tij/saj, në asnjë rrethanë nuk do të pranojnë dhurata, favore, privilegje apo premtime për ndihmë materiale nga ndonjë person që ka interes të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në procedurë para Këshillit.
11. Anëtari i Këshillit nuk do të përdorë, ose përpiqet të përdorë, pozitën e tij për të promovuar interesat personale ose interesat që kanë të bëjnë me ndonjë organizatë, person, firmë, biznes nga të cilat mund të ketë interes të drejtëpërdrejtë financiar apo material.

Neni 4 **Aktivitetet jashtë punës së Këshillit**

1. Në parim, anëtari i Këshillit mund të kryejë aktivitete jashtë mandatit të Këshillit, përfshirë ato veprimtari që janë pjesë e të drejtave të tij/saj si qytetar apo që përfaqësojnë interesat e tij, ose pasqyrojnë pavarësinë e tij/saj përveç nëse aktivitetet e tilla mund të kenë efekt negativ për paraqitjen dhe qëndrimin e anëtarit të Këshillit.
2. Anëtari i Këshillit mund:
 - a. të flasë, shkruajë, ligjërojë, jep mësim dhe të marrë pjesë në veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me ligjin, sistemin ligjor dhe me administrimin e drejtësisë, përfshirë angazhimin në këto veprimtari përmes agjencive qeveritare ose joqeveritare që i përkushtohen interesave të tilla, përveç nëse kufizohet ndryshe me ligj apo rregullore.
 - b. angazhohet në sporte, veprimtari çlodhëse dhe aktivitete tjera qytetare si dhe merr pjesë në veprimtari bamirëse.
3. Anëtari i Këshillit nuk mund të:
 - a. angazhohet në asnjë veprimtari, përfshirë veprimtari me karakter politik, që është në papajtueshmëri me funksionet e anëtarit të Këshillit.
 - b. Ushtrijë funksion në cilëndo parti politike.
 - c. angazhohet në ndonjë aktivitet që mund të komprometojë ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij/saj si anëtar i Këshillit.
4. Komunikimi i Anëtarëve të Këshillit me mediat dhe publikun do të udhëhiqet nga rregullat dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli dhe ligjet tjera të aplikueshme.
5. Anëtari i Këshillit nuk kërkon fonde për veten, ndonjë organizatë apo agjenci, nuk lejon që emri i tij/i saj të përdoret për të kërkuar fonde apo nuk lejon që prestigji i institucionit të Këshillit të përdoret për ato qëllime, përveç nëse lejohej nga rregullat dhe rregulloret e Këshillit.
6. Anëtari i Këshillit e ka të ndaluar të përdorë pozitën e tij/saj apo informatat e pranuar përmes pozitës së anëtarit të Këshillit për çfarëdo përfitimi personal ose për ndonjë person

tjetër apo organizatë. Për informatat e pranuar gjatë pozitës si anëtar i Këshillit ky kufizim vlen edhe pas përfundimit të mandatit të tij.

7. Anëtarët e Këshillit nuk mund t'iu përkasin organizatave që mbështesin apo nxisin diskriminimin apo çdo lloj veprimtarie që nuk përputhet me funksionet e tij/saj si anëtar i Këshillit.
8. Anëtari i Këshillit duhet t'ia paraqesë Agjencisë Kosovare Anti-Korrupsion pasuritë e tij në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

Neni 5 **Përgjegjësitë Administrative**

1. Anëtari i Këshillit do të kujdeset për përgjegjësitë administrative të tij/saj me profesionalizëm dhe vëmendje dhe bashkëpunon me anëtarët tjerë të Këshillit dhe organet administrative të Këshillit.
2. Në veçanti, anëtari i Këshillit:
 - a. Respekton detyrimet e nevojshme që i përkasin funksionit të tij/saj si anëtar i Këshillit sa i përket mbikëqyrjes së stafit nën kontrollin apo mbikëqyrjen e tij/saj;
 - b. Organizon veprimtarinë e tij/saj brenda Këshillit dhe respekton detyrimet e posaçme të kohës dhe detyrës që janë të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij/saj.
 - c. Respekton rregullat dhe rregulloret, çdo udhëzim administrativ të nxjerrë nga Këshilli në lidhje me aktivitetet, pa lejuar komprometuar mandatin e vendimmarrjes së institucionit të Këshillit.
3. Në lidhje me organizimin dhe punën e brendshme të Këshillit, anëtari i Këshillit shmang çdo ndikim të papranueshëm dhe promovon punën e drejtë të sistemit të drejtësisë së Kosovës.

Neni 6 **Ndërveprimi me kodet tjera të mirësjelljes**

1. Në rastin e kundërthënies në mes të dispozitave të këtij Kodi të Mirësjelljes dhe dispozitave të ndonjë kodi tjetër të mirësjelljes profesionale që vlen për anëtarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbizotëron ky kod.
2. Ky Kod mund të ndryshohet vetëm me vendim të KGJK-së.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.